



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1639 Prot.

Gjirokastrë, më 21/12/2020

V E N D I M

Nr. 42, datë 21.12.2020

**MIRATIMI I HAPJES SË PROGRAMEVE TË REJA,
NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Në zbatim të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika dh, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 14 pika 6 dhe pika 9, vendimit nr. 879 datë, 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 18.12.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" dhe udhëzimit nr. 1, datë 14. 01. 2020 për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë" Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 21. 12. 2020;

V E N D O S I

1. Të miratojë hapjen e programeve të reja të studimit si më poshtë:
 - a. Programin e studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në Financë Kontabilitet, ofruar nga departamenti i Kontabilitet – Financës në njësinë kryesore Ekonomik, i cili do të realizohet me 120 ECTS në 2 (dy) vite akademike.

- b. Programin e studimit me karakter profesional 2-vjeçar “Menaxher Mjedisi ”, ofruar nga departamenti i Biologji – Kimi në njësinë kryesore të Shkencave të Natyrës, i cili do të realizohet me 120 ECTS, në 2 (dy) vite akademike.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe një kopje e këtij vendimi i kalon Bordit të Administrimit për miratim.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. dr Bektash MEMA

(në mungesë dhe me porosi)

Nën /KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr Gëzim SALA

